

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 67 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Teksti i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2753/1 datë 13.06.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2870/2 datë 02.07.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 27-të mbajtur më 01.07.2024, miratoi sa vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim

1. PUBLIKISHT PARALAJMËRON Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e kryer të nenit 67 paragrafi (6) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), në atë mënyrë që në kuadër të shërbimit të tij programor gjatë një jave, gjegjësisht në periudhën prej 3 deri më 9 qershor 2024, nuk ka realizuar së paku 80% të konceptit programor për të cilin i është dhënë Leja për transmetim televiziv, PA1 nr.08-58 datë 07.09.2023.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me ark.nr.10-2753/1 datë 13.06.2024, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 67 paragrafi (6) të LSHMAAV, transmetuesi është i obliguar të realizon së paku 80% të konceptit programor për të cilin i është dhënë leja gjatë një jave.

Agjencia në kuadër të kompetencave të saj ligjore, përmes Sektorit për çështje programore, më datë 13 qershor 2024, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore (monitorim), sipas detyrës zyrtare ndaj shërbimit programor televiziv të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, transmetuar gjatë një jave, në periudhë nga 3 deri më 9 qershor 2024, ku u konstatua shkelje e nenit 67 paragrafi (6) nga LSHMAAV, gjegjësisht në periudhën e caktuar transmetuesi nuk ka realizuar së paku 80% të konceptit programor për të cilin i është dhënë leja e punës.

Përkatesisht, sipas konceptit programor për të cilin i është dhënë Leja për transmetim televiziv, PA1 nr.08-58 datë 07.09.2023, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë është zotuar të

jetë shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues; shërbimin programor ta transmetojë në gjuhën shqipe dhe maqedonisht; përfaqësimi i programit të saj në baza javore të jetë 10 orë; përfaqësimi i informacionit dhe i përmbajtjeve të tjera me rëndësi për zonën ku transmeton shërbimin programor gjatë javës të jetë - 12 orë, nga të cilat: 6 orë programe me funksion informativ; 2 orë programe me funksion edukativ dhe 4 orë programe me funksion argëtimi.

Rrjedhimisht, sipas Udhëzimit për mbikëqyrje të realizuar të konceptit programor, me ark.nr.01-2265/1 datë 03.05.2018, pikat (pozicionet) e lartpërmendura mirren për kritere të vlerësuar në përqindje, dhe atë sipas mënyrës në vijim: 1) formati i shërbimit - 45%; 2) gjuha e transmetimit të programit - 25%; 3) përfaqësimi i programit të saj në baza javore - 5% dhe 4) përfaqësimi i informacionit dhe përmbajtjeve të tjera me rëndësi për zonën në të cilën do të transmetohet shërbimi programor - 25%.

Në bazë të nenit 7 të Rregullores për formatet e shërbimeve programore të transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.172/2014), në shërbimin programor televiziv me format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara kryesisht përmbushin një nga tre funksionet mediatike, funksioni që kryesisht përmbushet nuk duhet të përfaqësohet me më pak se 50%, si edhe me më shumë se 65%. Pjesa tjetër e programit përbëhet nga programe që përmbushin dy funksionet e tjera mediatike, ku asnjë nga këto dy funksione nuk mund të përfaqësohet me më pak se 5% në totalin e programit të transmetuar gjatë një jave.

Prandaj, sipas të njëjtit nen të Rregullores për formatet e shërbimeve programore të transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.172/2014), shërbimi me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, atij për të cilin realisht është angazhuar SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, duhet të realizohet në atë mënyrë që - transmetimi i programeve me funksion argëtues duhet të jetë në intervalin - minimumi 50% - maksimumi 65% - të transmetimit total, program i klasifikuar funksionalisht për një javë. Mbikëqyrja në strukturën e konceptit programor njëjavor tregon se SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë ka planifikuar të transmetojë gjithsej - 86 orë dhe 22 minuta (64,23%) - programe me funksion argëtues, të shpërndara në mënyrë editoriale sipas llojeve të mëposhtme të programeve: 1 orë e 45 minuta - programe me horoskop / tarot / parashikues / interpretim ëndrrash; 3 orë – program sportiv (transmetim apo ritransmetim i ndeshjeve apo ngjarjeve sportive dhe revistave sportive); 62 orë dhe 46 minuta - program artistik (TV / kinematografik / i animuar - filma; seri / seriale / shfaqje teatrale / humor, etj.); 18 orë dhe 7 minuta – program muzikor (njësi programore muzikore-me fjalë, regjistrime dhe transmetime nga koncerte, festivale muzikore/valle/balet/opera, videoklipe etj) dhe 44 minuta – lojëra (garë me vlerë prodhuesi të ulët/të lartë, kuize, lojëra fati dhe lotari). Në javën e analizuar nga data 3 deri më 9 qershor 2024, nga potenciali 168 orë program televiziv për një javë, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë nuk ka transmetuar asgjë nga sa më sipër, pra 89 orë 42 minuta dhe 38 sekonda - nuk ka transmetuar aspak program, dhe për 78 orë 17 minuta dhe 22 sekonda ka transmetuar në mënyrë periodike ekskluzivisht klipe (video) muzikore, që është në kundërshtim me nenin 67 paragrafi (6) të LSHMAAV.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me ark.nr.10-2753/1 datë 13.06.2024, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në bazë të nenit 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, me datën 14.06.2024, i ka dërguar Shkresë me ark.nr.10-2753/2 datë 14.06.2024, ku i dorëzoi dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me ark.nr.10-2753/1 datë 13.06.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë t'i dorëzojë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Gjithashtu, shkresa më 17.06.2024, është dorëzuar edhe në formë elektronike në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV dhe në regjistrin e transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia.

Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 17.06.2024. Në afatin e paraparë, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 01.07.2024, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konstatoi që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 67 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer

programore me ark.nr.10-2753/1 datë 13.06.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2870/2 datë 02.07.2024, për shkak të konstatimit të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 01.07.2024, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me ark.nr.10 -2753/1 datë 13.06.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.